



Nr. 81 Viti i tetë i botimit Shkurt 2020

Në këtë numër do të gjeni:

- Aksione Komunitare për Zonat e Mbrojtura
- Mbrojtja e Dunave dhe Turizmi Kreativ
- 2 Shkurti - Dita Botërore e Ligatinave
- Lançohet projekti MPA_NETWORKS
- Nga Malet në Det
- Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore të ekosistemit të rezervatit natyror Kune-Vain-Tale
- Peshkaqenët dhe Rajat në Mesdhe
- ...pak histori...
- Njoftime

Aksione Komunitare në Zonat e Mbrojtura

Gëzuar 2 Shkurtin - Ditën Botërore të Ligatinave!
Ligatinat përfshijnë afër 6% të sipërfaqes së përgjithshme të globit dhe janë ndër mjediset më

produktive. Shërbimet e ekosistemeve ligatinore ofrojnë edhe përfitime të mëdha ekonomike. Vlen të përmendet orizi që është një bimë e zakonshme e ligatinave, dhe shërben si ushqim bazë për më se gjysmën e njerëzimit, pastaj rreth 2/3 e gjuetisë botërore të peshkut janë të lidhura me *Vijon në faqe 2*



Institute for Nature Conservation in Albania
Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

Vijon nga faqe 1 bregdetin dhe zonat e ligatinave. Gjithashtu, nga vlerat e ligatinave përfitojnë edhe: bujqësia, transporti, energjia, turizmi, etj.



Kompleksi dhe ndërveprimi i faktorëve fizik, kimik dhe biologjik i ekosistemeve ligatinore, mundëson që të kryejë shumë funksione, si p.sh. deponimin e ujit, depozitim të shkarkimeve të shirave dhe rrjedhjeve ujore, stabilizimin e kushteve klimatike, kontrollimin e përmytjeve dhe të erozionit.

Për shkak të vlerave dhe përfitimeve që ofrojnë ligatinat, shtetet e ndryshme po i kushtojnë vëmendje ruajtjes së tyre. Për këtë dëshmon rritja e vazhdueshme e numrit të ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, por edhe i shteteve nënshkruese të Konventës së Ramsarit, që nga viti 1971 e deri më sot Ligatinat konsiderohen si "djep i diversitetit biologjik", duke ofruar ujin dhe produktivitetin primar për ekzistencën e llojeve të shumta të bimëve dhe shtazëve. Ato mbështeten në përqendrimin e lartë të



gjitarëve, shpendëve, zvarranikëve, ujëtokësorëve, peshqve dhe llojeve jo kurrizore. 40% e organizmave

përdorin si habitat ligatinat. Kjo ditë i dedikohet jo vetëm ligatinave në teresi, por duke përfshirë një faktorë kyç të tyre që është biodiversiteti. Shfrytëzimi i biodiversitetit për qëllime ekonomike dhe fitimprurëse është një nga premiset e zhvillimit të ekonomive lokale dhe kombëtare. Por shfrytëzimi duhet të jetë njëkohësisht fitimprurës dhe i ekuilibruar, sepse shoqëria e konsumit dhe dëshira për të nxjerrë fitime shumë të mëdha e në një kohë mjaft të shkurtër, kanë sjellë degradimin e ekosistemeve. Diversiteti biologjik dhe varieteti i florës dhe i faunës, ekosistemeve dhe pejsazheve është një nga pasuritë tona më të mëdha. Ne duhet t'u kalojmë këtë trashëgimi natyrore brezave të ardhshëm si një sistem i qëndrueshëm.

Për të festuar ditën botërore të ligatinave, duke risjellë në vëmendjen e njerëzve rëndësinë që kanë




ligatinat dhe të mund të sigurojnë mbrojtjen e tyre, INCA në kuadër të projektit ACAP, realizoi një aktivitet me përfshirjen e nxënësve të shkollave të cilat jetojnë afër lagunës së Nartës, si një lagunë me rëndësi të madhe në Shqipëri, por ende nuk është e përfshirë në Konventën e Ramsarit. Laguna e Nartës si një lagunë me sipërfaqe të madhe, ka vlera të mëdha ekologjike, ku ndodhen dhe një numër i konsiderueshëm i shpendëve të ujit, si një vlerë e shtuar për të. □Ndër shpendët e ujit më të përhapur mund të përmendim flamingo *Phoenicopterus roseus*, rosën e egër *Anas crecca*, laroshja *Tadorna tadorna*, pelikani *Pelecanus crispus*, qyrylyku këmbëqirizë *Tringa totanus*, etj. Gjatë aktivitetit u realizua edhe mbjellja e fidanëve të pishës së butë me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollës "Pilo Prifti", *Vijon në faqe 3*

Vijon nga faqe 2 Novoselë shkolla industriale "Pavarësia", vullnetarë dhe dashamirës të natyrës dhe shoqata lokale (PPNE Vlorë), afër lagunës në Nartës, aktivitet i cili u shoqërua po ashtu edhe me vëzhgimin e shpendëve si një ndër elementët e biodiversitetit të cilët karakterizojnë lagunat.

Në kuadër të projektit ACAP, shkolla Bulka Nonda, Përmet realizoi një orë edukative mjedisore me temë "Bredhi i Hotovës, simboli i jetës dhe qetësisë", gjatë të cilës nxënësit krijuan në klasën e tyre një pasqyrim të këtij Parku Kombëtar duke e pasuruar edhe me elementë të mbledhur nga natyra si : gjethet dhe boqet.



Në kuadër të projektit ACAP, shkolla 9-vjeçare Shkolla "Meleq Gosnishti" Permet, zhvilloi një orë edukative mjedisore me temë "Ndërgjegjësojmë qytetarët për mbrojtjen e mjedisit", me qëllim realizimin e një minifushate e krijuar nga nxënësit në ambientet e shkollës dhe e prezantuar te qytetarët që kalojnë aty pranë, nëpërmjet broshurave me mesazheve mjedisore dhe shembullit që ndjekim mbi diferencimin e mbetjeve



Vazhdon puna për ngritjen e fidanishtes në ambientet e shkollës "Hasan Mehili" Dukat, në kuadër të projektit "Fëmijët për parkun e Llogarait", të mbështetur nga ACAP dhe INCA



Në këtë fidanishte po mbillen jo vetëm bimë të larta të cilat janë përfaqësuese të parkut të Llogara-it, por edhe bimë medicinale si çaji, sherebela etj., të cilat përdoren gjerësisht edhe nga komuniteti aty pranë. Janë pikërisht nxënësit e kësaj shkolle të cilët marrin pjesë në krijimin e saj dhe në mirëmbajtjen në vazhdim për t'u përdorur më pas edhe si zonë për zhvillimin e kurrikulës mësimore .

Duke u mbështetur edhe në kurrikulën mësimore, në shkollën "Lef Sallata" Vlorë, vazhdojnë orët mjedisore edukative me qëllim përfshirjen e nxënësve në çështjet e mjedisit.



Një nga temat e trajtuara ishin përdorimi i tingujve nga bota shtazore duke nisur që me komunikimin midis tyre si dhe dukurinë e ekolokacionit. Është mjaft e rëndësishme që brezat e ardhshëm të lidhin çdo tematikë mësimore jo vetëm me qenien e njeriut, por edhe me natyrën duke trajtuar çdo gjallesë në mënyrë të barabartë.

Vijon nga faqe 3 Në varësi të klimës, pozicionit gjeografik dhe peizazhit të oborrit të shtëpisë, shkollës dhe të vendit ku ndodheni, ju mund të vizitoheni nga dhjetëra lloje të ndryshme të shpendëve dimëruar gjatë muajve të dimrit. Zogjtë më të zakonshëm të dimrit përfshijnë: harabela, trishtila, gushëkuq etj. Pikërisht këta shpendë afrohen shumë në vendet e banimit, duke qenë



se kanë më të lehtë për të gjetur ushqim. Nxënësit e shkollës "Pilo Prifti" Novoselë, nga klasa e I-IV, në kuadër të projektit ACAP realizuan sot një orë edukative mjedisore lidhur me ndërtimin e ushqyesve për shpendët duke përdorur metodën e riciklimit.


Në kuadër të projektit ACAP dhe me mbështetjen e INCA, vazhdojnë orët edukative mjedisore në shkollën "Pilo Prifti", Novoselë, me temë "Sjellja jonë për një mjedis të pastër. Të diskutojmë lidhur me mjedisin dhe elementët e tij, zhvilluar me nxënës të klasës së 9



Gjatë kësaj ore nxënësit jo vetëm punuan lidhur me sjelljet negative që ndikojnë në biodiversitet, por edhe mbi aktivitetet që mund të bëjnë ata si nxënës dhe si pjesë komuniteti në ruajtjen e natyrës dhe mjedisit që

na rrethon.

Për të dhënë edhe mesazhin pozitiv, u mbyll kjo orë me mbjelljen e pemëve në oborrin e shkollës si një sjellje pozitive dhe si një shembull që duhet të ndiqet vazhdimisht edhe nga nxënësit e tjerë



Shkolla Zihni Toska - Berat Me ju gjithçka është e realizueshme. Projekti ACAP na krijon mundësi që të shpalojmë idetë dhe aftësitë tona. Një veprimtari mjaft e bukur në kuadër të Ditës së Shërbimit Pyjor për të dhënë mesazhe shumë kuptimplote për të mbrojtur pyjet, oksigjenin

e jetës sonë.

Nëpërmjet posterave të përgatitur tregojmë se natyra na shpërblen kur kujdesemi për të.

Faleminderit [Inca Shqipëria!](#)

Nxënësit ilustruan nëpërmjet punëve të tyre si e shohin dhe e mendojnë ata shpyllëzimin, duke

risjellë në mendje një sërë informacionesh lidhur me ndikimin që ka shpyllëzimi në biodiversitet, duke përfshirë këtu edhe njeriun



Vijon në faqe 5

Vijon nga faqe 4 Në kuadër të projektit ACAP dhe me mbështetjen e INCA, shkolla "Nikolla Xhuveli", Nartë zhvilloi një orë edukative mjedisore me temë "Bimët medicinale, përdorimi dhe rëndësia e tyre" Gjatë kësaj ore u studiuan disa nga bimët medicinale, u realizua mbjellja e tyre në ambientet e shkollës si dhe vëzhgimi në mikroskop i elementëve bimorë.



Në kuadër të projektit ACAP dhe me mbështetjen e INCA, u zhvillua një ore edukative për mjedisin në shkollën 9-vjeçare Bogdan - Berat me nxënësit e arsimit fillor.

"Trashëgimitë natyrore dhe kulturore" është tema e trajtuar nëpërmjet këtij ekskursioni në natyrë me



Edukimi mjedisor në shkollat fillore është një stad mjaft domethënës në zhvillimin e sjelljes, ndërgjegjësimit social dhe interesit. Në shkollë ne zhvillojmë vlera dhe sjellje të cilat do të qëndrojnë me ne përgjatë gjithë jetës dhe shpeshherë përcaktojnë se kush jemi. Prandaj ky lloj edukimi është një element mjaft i rëndësishëm që nxit interesin për kujdesin dhe mbrojtjen e natyrës që në hapat e parë, që ata janë në shkollë.



Nxënësit e klasës së parë të shkollës Pilo Prifti, Novoselë zhvilluan një orë edukative mjedisore duke nisur me sjelljen e parë për një mjedis cilësor, siç është mbjellja e luleve në ambientin ku ata mësojnë me orë të tëra, duke sjellë aromën e natyrës

nxënësit e shkollës "Hasan Mëhilli" Dukat, në kuadër të projektit ACAP dhe me mbështetjen e INCA, me qëllim, edukimin mjedisor.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte lidhja e natyrës dhe elementëve të saj me elementët historikë dhe kulturor. Në mënyrë që të kemi zhvillim të qëndrueshëm është mjaft e rëndësishme që zhvillimi i turizmit të bëhet në harmoni me natyrën. Kur si pjesë e turizmit përfshihen edhe elementët historikë të cilët ndodhen dhe ruhen në brendësi të një zone të mbrojtur, rëndësia për objekte të caktuar bëhet më e madhe kur ato përfshihen në brendësi të një zonë të mbrojtur, duke ofruar më shumë mundësi të njohësh edhe natyrën aty pranë.

Në pjesën më veriore të lagunës së Nartës, "Lagunën e Kallëngës", si një pjesë e vogël e kësaj

Vijon në faqe 6


Vijon nga faqe 5 lagune me bukuri natyrore si dhe vlera të biodiversitetit ndodhen po ashtu edhe bunkerët historikë ndër më të mëdhenjtë, që tërheqin një numër të madh të turistëve. Prania e tyre së bashku me lagunën dhe pyllin e Pishë Poro-së, përbëjnë një ekosistem harmonik dhe të ekuilibruar me vlera të mëdha natyrore dhe historike.



E rëndësishme për tu përmendur është fakti që në aktivitete terreni, por edhe në jetën e përditshme nxënësit duhet të shmangin përdorimin e bidonave plastik sa më shumë, prandaj për këtë arsye për të dhënë një mesazh efektiv sot bëme zëvendësimin e bidonave plastikë të gjithsecilit, me termusa të veçantë për mbajtjen e ujit, duke shmangur elementët 1-përdorimsh nga jeta e nxënësve.

Në kuadër të projektit ACAP, më datë 20-21/02ishim në qytetin e Përmetit, për zhvillimin e 2 orëve edukative mjedisore me nxënësit e shkollës "Meleq Gosnishti", me klasën e V dhe të VI, me tematikë "Kujdesi ndaj natyrës" dhe "Mjedisi dhe elementët ndotës të ujit, ajrit dhe tokës".

Çdo informacion i marrë për mjedisin dhe përfshirjen e nxënësve në të menduarit dhe nxjerrit të



rezultateve nga puna e tyre nxit edhe më tepër edukatën e tyre mjedisore, duke ndryshuar sadopak sjelljen në lidhje me mjedisin dhe natyrën që i rrethon.

Në kuadër të projektit ACAP, shkolla "Nonda Bulka", Përmet zhvilloi orën edukative mjedisore me temë "Rrjeti ushqimor në ekosistemet natyrore dhe ndikimet në prishjen e ekuilibrave", bazuar edhe në kurrikulën e tyre mësimore.

Një sërë faktorësh natyrorë ose të shkaktuara nga njeriu mund të ndikojnë në prishjen e këtyre ekuilibrave duke shkaktuar efekte negative të cilat ndjekin secilën hallkë ushqimore, që lidh organizmat me njëri tjetrin...



Pasditja ime e gjelbër -
kujdesi ndaj mjedisit një domosdoshmëri

INCA ka mbi 10 vjet që i ka kushtuar një vëmendie të veçantë Edukimit Mjedisor duke realizuar shumë aktivitete në kuadër të tij, duke kontribuar në përmirësimin e kurrikulave të shkollave 9-vjeçare, si dhe duke trainuar mbi 5000 mësues në gjithë shqipërinë.

Dy vitet e fundit ky komponent po mbështetet nga projekti ACAP, me fokus zonat e mbrojtura, duke u zbatuar në 3 zona pilote (në qarkun e Gjirokastrës-Përmet, qarkun e Vlorës, dhe atë të Beratit) si dhe me mbështetjen e gjerë të shkollave 9-vjeçare

Vlorë: Lef Sallata-Vlorë, Pilo Prifti-Novoselë, Balil Pelari-Orikum, Nikolla Xhuvëli-Nartë, Hasan Mëhilli-Dukat

Përmet: Nonda Bulka, Meleq Gosnishti

Berat: Zihni Toska, 22 Tetori, Shyqyri

Vijon në faqe 7

Vijon nga faqe 6 Lakra, Tomorri, Bogdan, Karkanjoz Përfitojmë nga rasti për ti falenderuar këto shkolla për mbështetjen si dhe një falenderim shkon edhe për Agjensinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura si dhe për Agjensitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura të Vlorës, Gjirokastrës dhe Beratit për mbështetjen e dhënë gjatë zhvillimit të aktiviteteve.

Ndiqui intervistën e koordinatorës së INCA-s në kuadër të projektit ACAP, ku INCA mbulon komponentin e Edukimit Mjedisor.

<https://youtu.be/165ksDVvqVY>



Mbrojtja e Dunave dhe Turizmi Kreativ

Më datë 3 Shkurt 2020, shoqata "Aleanca e Alpeve Shqiptare", në kuadër të projektit "Protection of Buna and Creative Tourism PRODUCT", si pjesë e programit LIVING BUNA që zbatohet nga INCA dhe financohet nga Fondacioni MAVA dhe IUCN, organizoi Kick-off meeting të projektit.

Qëllimet e projektit janë:

- Ruajtja e vlerave ekologjike dhe kulturore
- Ruajtja e kullotave: Dunat, kënatat me ujë të ëmbël
- Ruajtja e jetës së egër: Habitati shpendëve ujorë, migratorë dhe folezues.
- Ruajtja e burimeve ujore: Menaxhimi i mbetjeve
- Zhvillimi i kushteve të jetesës bazuar në përdorimin e qëndrueshëm të shërbimeve të ekosistemeve.
- Zhvillimi i sektorit të turizmit: Ekoturizmi, bazuar në turizmin familjar dhe tradicional.

Gjatë takimit, grupi i të rinjve "SKUADRA e GJELBER", me pjesmarrës nga të rinjtë e Smile Albania dhe vullnetarë të rrjetit, zhvilluan takime në shkollat përgjatë Lumit Buna për të dhënë mesazhin e rëndësisë së Ditës Botërore të Ligatinave.

Në fund të takimit, të ftuarit u bënë vetë pjesë e këtyre takimeve nëpër shkolla duke vizituar shkollën 9 -vjeçare të Velipojës.

Për t'u bërë pjesë e aktiviteteve të këtij projekti, DM! bëhu edhe ti pjesë e lëvizjes [#UnëRural](#)



2 Shkurti - Dita Botërore e Ligatinave

2 Shkurti - Dita Botërore e Ligatinave

Ligatinat dhe Biodiversiteti

Jeta lulëzon në ligatina

Biodiversiteti i ligatinave ka rëndësi

Biodiversiteti në ligatina - përse është i rëndësishëm

2 Shkurti i çdo viti është shpallur si "Dita Botërore e Ligatinave"; kjo ditë shënon datën e miratimit të

Konventës për Ligatinat në 2

Shkurt 1971 në qytetin Iranian

të Ramsar-it. Ligatinat ose

sistemet e "tokave të lagura",

janë sipërfaqe ujore të

përhershme ose përkohshme

deri në 6 metra thellësi, dhe

përbëjnë një ekosistem mjaft i

rëndësishëm që siguron larmi përfitimesh përfshirë

filtrimin e ujit, sigurimin e biodiversitetit, mbrojtjen e

bregdetit dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Publiku i gjerë është pak i ndërgjegjshëm për këto

shërbime të rëndësishme të ligatinave. Shumë pak

vetë e dinë se në vendin tonë 3% sipërfaqe së tokave

të lagura në bregdet, strehojnë 75% e vlerave të

biodiversitetit. Në jo pak raste, ligatinat janë

shndërruar në vende për hedhjen e mbeturinave apo

janë transformuar në toka buke apo terrene ndërtimi.

**World
Wetlands Day**
2 February 2020

Wetlands and biodiversity



"Ligatinat dhe Biodiversiteti" është tema për vitin 2020. Ligatinat janë të pasura me biodiversitet dhe janë një habitat për një larmi të madhe të specieve bimore dhe shtazore. Vlerësimet e fundit tregojnë një

rënie globale të biodiversitetit, ndërsa ligatinat po zhduken tre herë më shpejt se pyjet. Tema e këtij viti është një mundësi unike për të nxjerrë në pah

biodiversitetin e ligatinave, statusin e tij, pse ka rëndësi dhe promovuar veprime për të rikthyer humbjen e tyre.

Ligatinat janë një ekosistem mjaft i rëndësishëm që sigurojnë një larmi përfitimesh përfshirë filtrimin e ujit, sigurimin e biodiversitetit, mbrojtjen e bregdetit dhe

zbutjen e ndryshimeve klimatike. E ardhmja e njerëzimit varet nga ligatinat, megjithatë, gjysma e ligatinave në botë janë zhdukur gjatë shekullit të fundit.

Dita Botërore e Ligatinave është një mundësi e mirë për të kërkuar ndryshimin e situatës dhe ndërgjegjësuar publikun mbi rëndësinë që kanë

ligatinat për të ardhmen e njerëzimit.

Këto sfida përfshijnë çështjen globale të efektivitetit

të menaxhimit dhe më saktësisht menaxhimin e peshkimit në shkallë të vogël në MPA, ruajtjen e specieve të

lëvizshme dhe zhvillimin e mekanizmave të qëndrueshëm të financimit për MPA.

Në këtë takim morën pjesë edhe ekspertët e INCA.

Lançohet projekti MPA_NETWORKS

Ceremonia e lancimit të projektit MPA_NETWORKS u zhvillua në 4 shkurt në Marsejë.

Në takim morën pjesë përfaqësues nga 10 partnerët e projektit, si dhe nga disa partnerë të asocuar dhe

organizata të tjera, ku

u diskutua rreth

aktiviteteve të

projektit dhe sinergjive

që mund të nxiten rreth

Mesdheut. Ata do të

punojnë së bashku për

të ndërtuar rrjete më

të forta njerëzore dhe

të kontribuojnë në

efektivitetin e Zonave

të Mbrojtura Detare!

Projekti Mpa_Networks



Nga Malet në Det

07 Shkurt 2020 - Vlorë - Në kuadër të projektit "NGA MALET NË DET" mbështetur nga CEPF, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri - INCA, organizoi trajnimin për OSHC dhe komunitetin mbi "Advokim për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe pjesëmarrje aktive në vendimmarrje"

Projekti ka për qëllim të nxisë dhe të mundësojë një mjedis aktiv për shoqërinë civile dhe komunitetin, si dhe fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile dhe pjesëmarrës të ndryshëm të komunitetit për të qenë aktorë të pavarur efikas dhe të përgjegjshëm, për të rritur kapacitetin e tyre për të pasur dialog me qeverisjen qendrore që ndikon në proceset e politikave dhe ato vendimmarrëse dhe për t'i bërë institucionalisht të përgjegjshme për performancën e tyre ndaj qytetarëve dhe shoqërisë në shkallë të gjerë.

Trajnimi do të shërbejë edhe si një tryezë komunikimi me bashkëpunëtorët dhe OJF-të lokale për të diskutuar rreth zbatimit të aktiviteteve të projektit duke synuar rritjen e prezencës aktive dhe fuqizimin e

aftësive të OSHC-ve, aktorëve lokalë në zbatimin e legjislacionit, në luftën kundër korrupsionit dhe minimizimin e ndikimeve negative në menaxhimin e burimeve natyrore dhe të zonave të mbrojtura. Duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve dhe autoriteteve publike, komuniteteve lokale dhe mediave, synohet rrjetëzimi dhe ndërtimi i partneritetit mes tyre, në krijimin e një programi pune afatgjatë me fokus përmirësimin e zbatimit të planeve të

menaxhimit të zonave të mbrojtura pjesë e punës së projektit. Projekti është mbështetur në dokumentet kryesore të punës së menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe konkretisht në planet e menaxhimit të Parkut Kombëtar Llogara, Rezervatit Natyror i Menaxhuar i Karaburunit

dhe Parkut Kombëtar Detar i Karaburun-Sazanit.

Formësimi i një mesazhi bindës mbi rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore për politikëbërësit, subjektet dhe komunitetin është thelbësor, ndaj nxitja e procesit të advokimit për zbatimin e planeve të menaxhimit do të jetë pjesë e punës së përbashkët.



Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore të ekosistemit të rezervatit natyror Kune-Vain-Tale

nga Klubi Ekologjik Lezhë

Klubi Ekologjik Lezhë, në kuadër të projektit "Faqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri"/"Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore të ekosistemit të rezervatit natyror Kune - Vain - Tale" financuar nga Bashkimi Evropian dhe mbështetur nga INCA, në abjentet e Biblotekës "Gjergj Fishta" Lezhë, me pjesëmarrjen e



kontributin e dhënë në suksesin e eventetit. Ekspozita do të qëndrojë e hapur në ambjentet e Biblotekës "Gjergj Fishta" Lezhë për një periudhë mbi 20 ditore për qytetarët dhe në muajt në vazhdim, do të expozohet në të gjitha shkollat e mesme të Bashkisë Lezhë.

mbi 50 përfaqësues të rrjetit të OSHCM-ve, përfaqësuesve të pushtetit vendore, përfaqësues të AdZM Lezhë, përfaqësues të medias, celi ekspozitën fotografike mbi vlerat natyrore të Zonës së mbrojtur Kune-Vain-Tale, dhe promovimin e broshurës: "Ndikimet e lumit Drin në ekosistemin Kune-Vain-Tale". Grupi i ECL-së falenderon të gjithë pjesëmarrësit për



Në emër të ECL dhe të rrjetit të OSHCM-ve Lezhë, falenderojmë INCA Shqipëri për mbështetjen e dhënë në suksesin e arritur sot.



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian

Përmajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e zbatuesit të projektit dhe nuk reflekton pikpamjet e Bashkimit Evropian

Peshkaqenët dhe Rajat në Mesdhe



Deti Mesdhe është një nga pikat e nxehta të biodiversitetit për peshkaqenë, rajat dhe kimeret në botë, me rreth 86 specie që jetojnë në ujërat e tij (47 peshkaqenë, 38 raja dhe 1 kimere), që do të thotë gati 7% e peshqve kërcor në botë. Mjerisht, Deti Mesdhe konsiderohet si një nga vendet

më të rrezikshme në botë për peshkaqenë dhe rajat, me gati 50% të specieve të tij nën kërcënim. Nga 73 speciet e përfshira në vlerësim, 20 specie cilësohen si të rrezikuara në mënyrë kritike (CR), 11 si të rrezikuara (EN), 8 si vulnerable (VU), 9 si afër kërcënuara (NT) dhe 12 si me shqetësim të pakta. Trembëdhjetë specie janë ende të kategorizuara si me mangësi të të dhënave (DD) që zbulojnë mungesën e informacionit dhe pasigurinë në statusin e specieve që mund të jetë më keq sesa pritej me të dhënat aktuale.


Rreth 14.065 ton peshkaqenë dhe rrezet u kapën në Mesdhe në 2015. Kapjet më të mëdha raportohen nga Libia (4.260 t), Tunizia (4.161 t), Italia (1.347 t), Egjipti (1.141 t), Spanja (918 t) dhe Greqia (800 t). Italia është një nga tregjet më të mëdha të konsumit në botë të mishit të peshkaqenëve dhe renditet si importuesi i tretë më i madh në botë për nga vëllimi. Ky mish peshkaqeni furnizohet kryesisht përmes prodhuesve kryesorë evropianë, duke qenë Spanja furnizuesi kryesor me një mesatare vjetore prej 49% në vëllim të importeve totale të mishit të peshkaqenëve.

Peshkimi rastësor

Ekzistojnë disa kërcënimë që prekin peshkaqenë dhe rajat në Detin Mesdhe, por mbipeshkimi duket të jetë më i rëndësishmi, edhe pse nuk ka ndonjë peshkim tipik të peshkaqenëve në rajon. Peshkaqenët dhe rajat kapen rastësisht në pjesën më të madhe të peshkimit

mesdhetar. Sidoqoftë, ekziston një hendek i rëndësishëm i njohurive pasi niveli i kapjeve rastësore dhe hedhjet në det nuk raportohen siç duhet. Rrjetat fundore dhe grepat e gjatë janë peshkimi më i rëndësishëm për kapjen rastësore të peshkaqenëve. Peshkimi me grepa të gjatë që prek më së shumti peshkaqenët dhe rajat pellagjike (grepa me fill të gjatë pellagjik), por edhe speciet bentike (rrjetat fundore). Kapja rastësore e peshkaqenëve dhe rajave, përfaqësojnë rreth 10-15% të biomases së kapjeve të analizuar në peshkimin e tonit dhe peshkut të detit. Deti Alboran është zona më e rëndësishme me 34,3% e ndjekur nga deti Adriatik me 15,1% (Megalofonou et al., 2005b).

Për të përmirësuar njohuritë mbi speciet e rrezikuara të peshkaqenëve dhe rajave, INCA në bashkëpunim me FAO dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (drejtorinë e peshkimit), ka hartuar një katalog të specieve që janë parë dhe kapur rastësisht me shpesh në ujërat detare pranë bregdetit shqiptar. Ky katalog do të ndihmojë peshkatarët për të dalluar më mirë speciet që janë me status ruajtjeje dhe mbrojtjeje nga IUCN. Vlerësimi korrekt i specieve do të ndihmojë në regjistrimin e tyre në kohën e kapjes si dhe në



statistikat e peshkimit në ndihmë të mobnitorimit të specieve të rrezikuara në territorin e ujërave detare shqiptare për të pasuruar më shumë me informacion mbi prezencën e llojeve të ndryshme të peshkaqenëve dhe rajave duke nxitur dhe analizimin e kushteve dhe

shpeshtësinë e pranisë së tyre në këto ujëra.

Ky katalog është hartuar në kuadër të projektit SafeSHARKS që financohet nga fondacioni MAVA dhe zbatohet nga INCA në partneritet me WWF Itali.



...PAK HISTORI...

...10 vjet më parë ...

Miratohet Ligji nr.10253, datë **11.03.2010** "Për gjuetinë". Ky ligj ka për qëllim: a) përcaktimin e rregullave e të kërkesave për zhvillimin e gjuetisë, si një veprimtar tradicionale, sportive, çlodhëse dhe turistike; b) menaxhimin e qëndrueshëm të gjuetisë, duke e vlerësuar faunën e egër si pasuri kombëtare që administrohet dhe mbrohet me ligj; c) garantimin që parimet për gjuetinë të zbatohen në mënyrë rigorozë, duke ruajtur tërësinë e ekosistemit dhe baraspeshën ekologjike; ç) mosdëmtimin e llojeve të faunës së egër

e të habitateve të tyre gjatë ushtrimit të gjuetisë; d) respektimin e së drejtës së gjuetisë dhe të të drejtave mbi gjahun, mbi trofetë e produktet e gjuetisë dhe të tregtimit të tyre...

Me ligjin nr.7/2014 "Shpallet Moratoriumi i Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i ligjit është përmirësimi i gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie. Ndërsa objekti i tij është ndalimi i ushtrimit të gjuetisë në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë...

...11 vjet më parë ...

...me VKM nr.241, datë **06.03.2009** miratohet "Lista e llojeve të huaja invazive dhe për përcaktimin e procedurave, për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në pikat doganore të vendit". Sipas këtij vendimi...Ndalohet futja në territorin e Republikës së Shqipërisë të llojeve të huaja invazive, sipas përcaktimit të shtojcës I... Ndalimin e futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të ekzemplarëve të rinj, të llojeve të huaja, me shkallë invazioni 3, sipas shtojcës II...Lejimin ose ndalimin, për rastet e tjera, të një lloji të huaj, për t'u importuar ose për t'u

introduktuar në territorin e vendit tonë, mbështetur në vlerësimin e rrezikut, që mbart importimi ose introduktimi i tij, i cili vlerëson shkallën e invazionit të llojit të huaj....Vlerësimi i rrezikut të një lloji të hua është vlerësimi i pasojave të introduktimit dhe mundësisë së instalimit të një lloji të huaj, duke përdorur informacionin shkencor. Menaxhimi i rrezikut përcakton masat, që duhen zbatuar për t'i reduktuar ose menaxhuar rreziqet e identifikuar gjatë vlerësimit të rrezikut... Mos lejimin, nga administrata doganore, e futjes, në territorin doganor, të llojeve të huaja, kur subjektet nuk janë të pajisura me leje....etj.

...20 vjet më parë ...

...me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.82, datë **02.03.2000** shpallet Park Kombëtar, në mbrojtje të shtetit, zona arkeologjike e Butrintit, me sipërfaqe 25 km².

Bazuar në rekomandimet e disa studime të kryera për këtë territor, kompleksi natyror ligatinor i Liqenit të Butrintit dhe rrethinat e tij, përfshi edhe kepin e Stillos, me VKM nr.693, datë 10.11.2005, u rishpall Park Kombëtar, me sipërfaqe të zgjeruar prej 8,591.2 ha.

Në kuadrin e projektit të Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare (ICZMCP), u hartua dhe plani i menaxhimit të PK të Butrintit, i cili u miratua, sipas dispozitave të ligjit "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, me urdhrin nr.404, datë

09.06.2011 të ministrit të Mjedisit. Mbi bazën e rekomandimeve të planit të menaxhimit, me VKM nr.134, datë 20.02.2013, sipërfaqja e parkut u zgjeruar në 9,424.4 ha, nga e cila 883.2 ha është zonë detare.

Territori natyror i kompleksit ligatinor të Butrintit (ku u përfshinë Liqeni i Butrintit, zona arkeologjike e PK të Butrintit, Kepi i Stillos dhe ishujt e Ksamilit), me sipërfaqe të përgjithshme prej 13,500 ha, me VKM nr.531, datë 31.10.2002, shpallet zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur, për t'u përfshirë në listën e Konventës (Ramsar) "Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë".

Konventat Ndërkombëtare ku Shqipëria është palë

Konventa "Për tregëtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër" (CITES).

Është nënshkruar në Uashington D.C, më 3 Mars, ndryshuar në Bon, më 22 Qershor 1979. Shqipëria ka aderuar me Ligjin nr. 9021, datë **06 Mars 2003** "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër" (*Fletore Zyrtare nr.22, datë 02.04.2003, faqe 665*). Sipas kësaj konvente

shtetet anëtare janë të detyruar të zbatojnë detyrimet e saj dhe shtojcat përkatëse. Në këto shtojca janë përfshirë të gjitha speciet e rrezikuara për zhdukjen që janë ose mund të ndikohen nga tregtia. Tregtia e ekzemplareve të këtyre llojeve duhet të jetë objekt i një rregulloreje strikte të veçantë me qëllim për të ndaluar rrezikimin e mëtejshëm të jetës së tyre dhe duhet lejuar vetëm në raste të veçanta. Palët nuk duhet të lejojnë tregtinë e ekzemplarëve të llojeve që përfshihen në shtojcat I, II dhe III, përveç në përputhje me kushtet e Konventës.

Konventa e ligatinave të rëndësisë ndërkombëtare, veçanërisht si habitat i shpendëve të ujit (Ramsarit).

Më **29 Mars 1996** Shqipëria aderohet në konventën Ramsar. Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 29.03.1996.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 581, datë 29 Qershor 1993 ishte hapi i parë i cili dha miratimin për aderim në këtë Konventë.

Me VKM nr. 413, datë 22 Gusht 1994, zona Divjakë-Karavasta, shpallet "Ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur", me sipërfaqe 20,000 ha dhe përfshihet në listën e kësaj konvente (*nr.site 781, datë 29.11.1995*).

Me VKM nr.531, datë 31.10.2002 kompleksi ligatinor i Butrintit dhe territori përreth tij, me sipërfaqe 13,500 ha, shpallet zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur dhe përfshirjen e tij në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë (*nr.site 1290, datë 28.3.2003*).

Me VKM nr. 683, datë 02.11.2005, kompleksi ligatinor i liqenit të Shkodrës dhe zona e lumit Buna, me sipërfaqe 49,562 ha, shpallet zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur dhe përfshihet në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht, si habitate të shpendëve ujorë (*nr.site 1598, datë 2.2.2006*).

Ndërsa me VKM nr.489, datë 13.06.2013, kompleksi natyror i liqeneve të Prespave e territoret përreth, me sipërfaqe 15,119 ha, shpallet zonë natyrore

veçanërisht e mbrojtur dhe përfshihet në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht, si habitate të shpendëve ujorë (*nr.site 2151, datë 3.7.2013*).

Aktualisht sipërfaqja e përfshirë në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare arrin në 98,181 ha.

Shqipëria bëhet palë e kësaj konvente, më 26 Mars 1996. Njihet Konventa e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, kryesisht për mjediset e lagëta të shpendëve ujor. Me nënshkrimin e saj duhet të plotësohen edhe disa detyrime si: (i) përcaktimin e një ligatine për t'u përfshirë në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, (ii) marrjen e masave për mirëadministrimin e tyre, etj., për rrjedhojë edhe ruajtjen e llojeve, veçanërisht të shpendëve ujorë. Konventa e Ramsarit ka si objekt kryesor të nxitë përgjegjësitë e përbashkëta të vendeve nënshkruese në mbrojtjen e zonave të lagura, të cilat janë të rëndësishme për shpendët e ujit, të cilët janë banorët e përhershëm të ligatinave, dhe ç'ka mund, gjithashtu, të nxisë "përdorimin e zgjuar" të ekosistemeve të lagura. Zbatimi i këtyre përgjegjësi po realizohet në ekosistemet e përfshirë në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht, si habitate të shpendëve ujorë.

Konventa "Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisin natyror në Europë" (Bernës).

Është miratuar më 19 Shtator 1979. Më 31 Tetor të vitit 1995 u nënshkrua edhe nga vëndi ynë. Konventa është ratifikuar më **2 Mars 1998**.

Direktiva 1999/22/EC e 29 Marsit 1999 lidhur me mbajtjen e kafshëve në kopshtet zoologjike.

Direktiva 83/129/EEC e 28 Marsit 1983 lidhur me importin në shtetet anëtare të lëkurës së disa llojeve të vegjlish të fokave dhe produkteve të derivuara prej tyre.

Ligj nr. 29, datë 17.03.2016 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2013, për projektin "Rezervati ndërkufitar i biosferës në Prespë".

UDHËZIM nr. 2, datë 03.03.2017 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje".

Njoftime

- 3 Mars - Dita Botërore e Jetës së Egër
- 5 Mars - Dita Botërore e Eficiencës së Energjisë
- 12 Mars - Dita Mbill një Lule
- 14 Mars - Dita Ndërkombëtare e Veprimit për Lumenjtë
- 21 Mars - Dita Ndërkombëtare e Pyjeve
- 22 Mars - Dita Botërore e Ujit
- 23 Mars - Dita Botërore e Meteorologjisë
- 28 Mars - Ora e Tokës (e shtuna e fundit e marsit)

Për të lexuar Ditari Natyrës në vite ... <http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

1 - INTERNATIONAL MEETING ON MARINE RESEARCH 2020 - 16th and 17th of July, 2020

The **IMMR'20** is an international congress planned to discuss novel scientific knowledge on marine resources and research towards the sustainability of our planet. The scientific programme places under the spotlight innovative research in: Aquaculture, Biodiversity, Conservation and Coastal Management, Blue Biotech, Fisheries and Management, Seafood Technology.

More information can be found in www.immr.ipleiria.pt or by contacting immr@ipleiria.pt

IMPORTANT DATES

Deadline for abstract submission / April 06, 2020

Notification of acceptance / April 30, 2020

Deadline for early registration / May 31, 2020

2 - Call for Proposals / LandSense Innovation Challenge Call is open! (Earth Observation & Citizen Science)

LandSense Innovation Challenge / Data-driven solutions for environmental

More information: <https://landsense.eu/Challenge>

Deadline: April 10, 2020

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.


Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Grupimi "Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë"



Organizatrat Partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Ergi Petanaj

Adr.:Rruga "Islam Alla"
Pallati IVEA, Kati I
1001 Tirana-Albania

Tel.: +355 (0) 422 31 437
Fax: +355 (0) 422 31 437
E-mail: info@inca-al.org

www.inca-al.org;
info@inca-al.org;
<https://www.facebook.com/inca.albania/>;
<https://twitter.com/AlbaniaInca>

INCA ALBANIA   